



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
MINISTRI

Nr. 1719 Prot.

Tiranë, më 16 9 2020

URDHËR

Nr. 220, Datë 16 9 2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ZBATIMIN E PRAKTIKAVE
PROFESIONALE NË BIZNES NË KUADËR TË NDJEKJES SË PROGRAMEVE TË AFP-
SË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL"

Në mbështetje të nenit 7, 15 dhe 22 të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zbatimin nga ana e ofrueseve publikë të arsimit dhe formimit profesional të Rregullore "Për zbatimin e praktikave profesionale në biznes në kuadër të ndjekjes së programeve të AFP-së në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional", bashkangjitur këtij Urdhëri. Për drejtimet/profilet ekzistuese për të cilat nuk ekziston infrastruktura fizike për të zbatuar praktikat profesionale në mjediset e ofruesit, brenda 1 (një) viti të garantohet krijimi i kushteve të nevojshme për zbatimin e saj sipas kësaj Rregulloreje.
2. Ngarkohen Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësisimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje.


MINISTËR
Anila DENAJ

RREGULLORE

Nr. _____, datë _____, 2020

PËR ZBATIMIN E PRAKTIKAVE PROFESIONALE NË BIZNES NË KUADRIN E NDJEKJES SË PROGRAMEVE TË AFP-SË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton procedurat për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në biznes të nxënësve dhe kursantëve të arsimit dhe formimit profesional (AFP-së) në kuadër të arritjes së kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KShK) sipas skelet-kurrikulave përkatëse, si dhe të kursantëve në kuadër të programeve të kurseve të unifikuara të formimit profesional të cilat ofrohet nga ofruesit publikë të AFP-së. Më konkretisht, kjo rregullore përcakton:

- Përgjegjësitë e institucioneve qendrore, partnerëve socialë, ofruesve publikë të AFP-së dhe bizneseve të angazhuara në zbatimin e praktikave profesionale në biznes;
- Procedurat për planifikimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në biznes;
- Instrumentet që aplikohen në zbatimin e praktikave profesionale.

Neni 2 Terma, përkufizime (Fjalorth)

Të nxënit në vendin e punës nënkupton proceset dhe rezultatet e të nxënit, që ndodhin kur dikushrealizon një punë (produktive) në një mjedis real pune.

Praktika profesionale si pjesë integrale e një programi formal të AFP-së është një ndër format e të nxënit nëpërmjet punës.

Në kuptimin e kësaj Rregulloreje "Praktika profesionale në biznes":

- është praktika profesionale që bën të mundur të nxënit nëpërmjet punës së mirëfilltë për të prodhuar të mira materiale dhe/ose kryer shërbime në një mjedis të vërtetë pune për të garantuar arritjet e rezultateve të nxënit në kualifikimin profesional përkatës;
- kryhet në shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera jo publike, institucionet e ndërmarrjet shtetërore si dhe entet e tjera publike, që në vijim quhen "biznese" ku kryhet praktika profesionale në biznes;
- është pjesë integrale e programit mësimor për kualifikimet profesionale përkatëse për nivelet 2-5 të KSHK-së, si dhe për kurset e unifikuara të formimit profesional;
- kryhet nga nxënësit/kursantët në përmbushje të programit mësimor, zbatohet në bashkëpunim me biznesin, në të cilin kryhet, monitorohet nga ofruesi i AFP-së dhe vlerësohet nga ofruesi në bashkëpunim me biznesin në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d. zhvillohet gjatë periudhës së kualifikimit, duke përfshirë periudhën e pushimeve shkollore në kualifikime profesionale të caktuara, sipas një kontrate tip ndërmjet ofruesit të AFP-së, biznesit dhe nxënësit/kursantit ose përfaqësuesit ligjor të tij.

Koordinator për marrëdhëniet me biznesin është anëtar i stafit të ofruesit të AFP-së dhe njësisëpërkatese të zhvillimit, i cili është përgjegjës për identifikimin dhe koordinimin e marrëdhënieve të ofruesit të AFP-së me bizneset partnere, si dhe me partnerët socialë në tërësi.

Biznes quhet çdo kompani, organizatë publike ose jopublike, e cila angazhohet në zbatimin e programit të praktikave profesionale në biznes sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje dhe kuadrit ligjor e rregullator në tërësi.

Program i praktikës profesionale në biznes përmban kompetencat profesionale, si dheveprimtaritë/ vendet e punës, në përmbushje të programit të kualifikimit profesional/kursit përkatës, të cilat nxënësi/kursanti do t'i përvetësojë gjatë periudhës së praktikës në biznes.

Grafiku i praktikës profesionale në biznes përfshin grafikun e shpërndarjes kohore së praktikaveprofesionale të klasave/kurseve në biznese të ndryshme, si dhe grafikun e shpërndarjes kohore individuale të nxënësve/kursantëve në poste pune të caktuara në bizneset përkatëse.

Kontrata e praktikës profesionale në biznes është marrëveshja e mbështetur në legjislacioninpërkates të AFP-së, arsimit para universitar, në legjislacionin përkatës të punës, si dhe në legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve në punë, e cila nënshkruhet ndërmjet biznesit, institucionit të AFP-së dhe nxënësit/kursantit ose përfaqësuesit të tij ligjor.

Instruktori në biznes është personi përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e praktikësprofesionale në biznes të nxënësve/kursantëve.

Neni 3

Qëllimi i praktikës profesionale në biznes

Qëllimi i praktikës profesionale në biznes është të zhvillojë dhe konsolidojë njohuritë dhe shprehitë profesionale, si dhe kompetencat e përgjithshme duke përfshirë kulturën e punës, personalitetin dhe ndjenjën e përgjegjësisë, të nxënësve/kursantëve për përvetësimin e kualifikimit profesional/kursit dhe ushtrimin e profesionit.

Neni 4

Forma, periudha, kohëzgjatja dhe oraret e zhvillimit të praktikës profesionale në biznes

1. Praktika profesionale në biznes zhvillohet në bllok dhe/ose e shpërndarë.
2. Praktika profesionale në biznes zhvillohet në periudha të ndryshme në koordinim me organizimin e punës në biznes, si në periudhën e zhvillimit të programit mësimor të kualifikimit profesional/kursit të unifikuar të formimit profesional, ashtu edhe gjatë fundjavave dhe gjatë periudhës së pushimeve.
3. Oraret e zhvillimit të praktikës profesionale në biznes për nxënësit/kursantët deri në moshën 18 vjeç, zhvillohen në përputhje me "Rregulloren për mbrojtjen e fëmijëve në punë", miratuar me VKM, nr.108, datë 15.02.2017, dhe nuk mund të jetë më shumë se 30 orë në javë dhe më shumë se 6 orë në ditë.

4. Për të llogaritur vëllimin mësimor gjatë praktikave profesionale në biznes, merret në konsideratë fakti që 6 orë punë 60 minutëshe në biznes janë të barasvlefshme me 8 orë mësimore 45 minutëshe.
5. Kohëzgjatja dhe periudha e zbatimit të praktikës profesionale në biznes përcaktohet në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë ndërmjet ofruesit të AFP-së dhe bizneseve përkatëse pjesëmarrëse. Në çdo rast, për çdo kualifikim profesional të niveleve 2-5 të KSHK-së, periudha e zbatimit të praktikës profesionale në biznes nuk duhet të tejkalojë 50% të kohës totale të praktikës profesionale sipas programit të kualifikimit profesional.
6. Ngarkesa mësimore e mësuesit të praktikës profesionale të ofruesit të AFP përcaktohet duke konsideruar shumën e orëve mësimore për trajtimin e praktikës profesionale në mjediset e ofruesit dhe të orëve mësimore për monitorimin e praktikës profesionale në biznes.

Neni 5

Praktika profesionale në periudhat e pushimeve shkollore

1. Praktikant profesional në biznes kryhen edhe gjatë periudhës së pushimeve shkollore për kualifikime profesionale të arsimit të mesëm profesional.
2. Kohëzgjatja e praktikës profesionale në biznes në periudhat e pushimeve shkollore përcaktohen në skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale përkatëse.
3. Qëllimet e praktikës profesionale në periudhat e pushimeve shkollore është që nxënësi:
 - a. të konsolidojë njohuritë e shprehitë e fituara nga ndjekja e programit mësimor;
 - b. të shkathhtësohet profesionalisht në përputhje me pritshmëritë për profesionistët e sektorit;
 - c. të ushtrojë kompetencat profesionale të përvetësuara në shkollë në realitetin profesional;
 - d. të komunikojë në mënyrë korrekte, miqësore dhe me vetëbesim me eprorët dhe kolegët;
 - e. të përvetësojë një qasje pozitive për punën dhe profesionin në sektorin përkatës.
4. Praktika profesionale në periudhën e pushimeve shkollore kryhet në biznese të identifikuar nga shkolla dhe të cilat kanë bashkëpunim të vazhdueshëm gjatë vitit shkollor dhe/ose në biznese të identifikuar nga vetë nxënësit, por të cilat përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.
5. Nxënësi mbikëqyret nga instruktori në biznes dhe dorëzon nëshkollëvërtetimin e praktikës profesionale.

Neni 6

Ndalimi i punëve të vështira ose të rrezikshme

Është kategorikisht e ndaluar që gjatë praktikës profesionale në biznes nxënësit/kursantët të bëjnë punë që kategorizohen të vështira ose të rrezikshme sipas kuartrit ligjor në fuqi.

Neni 7

Pagesa e praktikës profesionale në biznes

1. Biznesi mund të kryejë pagesa që lidhen me ushqimin, transportin, dhe shërbime/kompensime të tjera të nevojshme për zbatimin e praktikës profesionale në biznes nëpërputhje me kuartrin ligjor në fuqi.
2. Marrëdhënia e punës të angazhimit të nxënësit/kursantit jashtë kushteve kontratës për zbatimin e praktikës profesionale në biznes, rregullohet në bazë të legjislacionit përkatës të punës.

KREU II
PËRGJEGJËSITË DHE FUNKSIONET KRYESORE
PËR MUNDËSIMIN DHE ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE PROFESIONALE NË BIZNES

Neni 8
Ofruesit e AFP-së

1. Çdo ofruar i AFP-së është institucioni rregullator përgjegjës për marrëdhënien me bizneset, që angazhohen në zbatimin e praktikave profesionale. Në kuptimin e kësaj rregulloreje, ofruari i AFP-së ka këto përgjegjësi e funksione:
 - a. Identifikon nëpërmjet njësisë së zhvillimit bizneset potenciale në sektorët ekonomikë relevantë për kualifikimet profesionale që ofrohen prej tij;
 - b. mban e përditëson informacionin për bizneset në rajon sipas sektorëve ekonomikë të rëndësishëm për programet e AFP-së të ofruara prej tij;
 - c. ngre mekanizma funksionalë për përzgjedhjen e bizneseve që pranojnë nxënës/kursantë për realizimin e praktikave profesionale në biznes;
 - d. planifikon në bashkëpunim me bizneset zbatimin e programeve të praktikës profesionale në biznes, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi;
 - e. planifikon e garanton angazhimin e mësuesve të praktikës profesionale për monitorimin e nxënësve/kursantëve gjatë praktikave në biznese;
 - f. garanton pjesëmarrjen në praktika profesionale të nxënësve/kursantëve e në përputhje me programin e praktikës profesionale në biznes;
 - g. nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi (memorandume mirëkuptimi) me bizneset e identifikuar;
 - h. nënshkruan kontratën e praktikës profesionale në biznes, si një nga palët nënshkruese;
 - i. garanton vlerësimin e vazhduar të nxënësve/kursantëve gjatë praktikave profesionale në biznes, në bashkëpunim me instruktorët e biznesit
 - j. garanton përfshirjen e instruktorëve të biznesit në vlerësimin përfundimtar (provimet), në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi;
 - k. vlerëson bashkëpunimin e merr masa për përmirësimin e bashkëpunimit me bizneset me qëllim rritjen e vazhdueshme të cilësisë së praktikave profesionale.

Neni 9
Bizneset

2. Kompanitë / institucionet që mundësojnë realizimin e praktikave profesionale:
 - a. Vënë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e praktikave profesionale në biznes, sipas përcaktimeve të programit përkatës;
 - b. Vënë në dispozicion staf të kualifikuar (instruktorë në biznes) për udhëzimin dhe mbikëqyrjen e nxënësve/kursantëve gjatë praktikës profesionale në biznes;
 - c. Nënshkruajnë kontratat e praktikave profesionale në biznes për çdo nxënës/kursant, si një nga palët nënshkruese;
 - d. Në bashkëpunim të ngushtë me mësuesin e praktikave profesionale realizojnë dhe dokumentojnë realizimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale në biznes;
 - e. Marrin pjesë në provimet përfundimtare të praktikës profesionale, sipas përcaktimeve të kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

- f. Vënë në dispozicion, sipas mundësive dhe kushteve specifike, mundësi transporti dhe shërbime/lehtësi të tjera për nxënësit/kursantët gjatë ndjekjes së praktikës profesionale në biznes.

Neni 10

Kriteret për përfshirjen e bizneseve në praktikat profesionale

Biznesi do të konsiderohet i përshtatshëm për realizimin e praktikave profesionale të nxënësve/kursantëve nëse:

- a) është i regjistruar dhe e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me rregullat e tregut dhe legjislationin në fuqi;
- b) është anëtar i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë ose Dhomës së Zejeve;
- c) gëzon reputacion në rajon / zonë si biznes i qëndrueshëm;
- d) ushtron veprimtarinë e tij në një fushë të përshtatshme dhe që përputhet me drejtimit dhe profilet profesionale që ofron ofruesi i AFP, në kuadër të të cilave zhvillohet praktika profesionale në biznes;
- e) zotëron dhe është i gatshëm të vë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme (pajisje, poste pune) për realizimin e praktikës profesionale në biznes.
- f) ka mundësinë të angazhojë një specialist në rolin e instruktorit të biznesit i cili zotëron aftësi profesionale dhe personale të përshtatshme për të udhëhequr e mbikëqyrur nxënësit/kursantët gjatë praktikës profesionale në biznes;

Neni 11

Kriteret për angazhimin si instruktor në biznes

Punonjësi, i cili do të angazhohet si instruktor në biznes, përzgjidhet nga një Komision i përbërë nga një përfaqësues i institucionit publik të AFP-së dhe një përfaqësues i biznesit ku do të kryhet praktika profesionale, nëpërmjet intervistave dhe duhet të përmbushë këto kriteret profesionale dhe personale:

- a) të ketë përvojë pune të paktën 3-vjeçare në profesion a profesione, që lidhen drejtpërdrejt me programin e praktikës profesionale në biznes;
- b) të zotërojë aftësi të mira organizative dhe planifikuese;
- c) të jetë i aftë të udhëheqë e të mbikëqyrë ecurinë e nxënësit/kursantit gjatë praktikës në biznes dhe përvetësimin e kompetencave profesionale;
- d) të jetë i aftë të vlerësojë ecurinë dhe arritjet e nxënësit/kursantit gjatë praktikës profesionale në biznes;
- e) të zotërojë aftësi të mira komunikimi.

KREU III

PLANIFIKIMI DHE KOORDINIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE NË BIZNES

Neni 12

Kushtet e planifikimit të praktikave profesionale

1. Planifikimi i praktikave profesionale në biznes bëhet në bazë të programit të kualifikimit profesional ose programit të kursit të unifikuar të formimit profesional).

2. Planifikimi bëhet duke marrë parasysh numrin e nxënësve/kursantëve sipas drejtimit / profilit / kursit përkatës.
3. Kushti i domosdoshëm për planifikimin e praktikave profesionale në biznes është identifikimi paraprak i bizneseve potenciale për realizimin e tyre.

Neni 13

Programi i praktikës profesionale në biznes

1. Programi i praktikës profesionale në biznes:
 - a. është specifik sipas kualifikimit/kursit përkatës;
 - b. bazohet në rezultatet e të nxënësve të programit përkatës
 - c. Mban parasysh lidhjen ndërmjet proceseve të punës, në të cilat do të përfshihet nxënësi/kursanti, dhe programit përkatës.
2. Programi i praktikës profesionale në biznes hartohet nga ofruesi i AFP-së në bashkëpunim dhe koordinim me instruktorin/instruktorët e biznesit sipas formatit të rekomanduar në këtë rregullore në Shtojcën 2.

Neni 14

Identifikimi dhe përzgjedhja e bizneseve për praktikën profesionale

1. Koordinatori për marrëdhëniet me biznesin në njësinë e zhvillimit është përgjegjës për identifikimin dhe mbledhjen e informacionit mbi bizneset e rajonit, të cilat operojnë në sektorët ekonomikë relevantë për programet e AFP-së së ofruara nga institucioni.
2. Koordinatori harton listën e bizneseve të gatshme për bashkëpunim;
3. Drejtoria e ofruesit të AFP-së ngre një grup pune për përzgjedhjen e bizneseve që do të angazhohen drejtpërdrejt në zbatimin e praktikave profesionale në biznes. Grupi përbëhet nga përfaqësues të vetë ofruesit të AFP-së, përfaqësues të zyrës rajonale/vendore të punësimit dhe përfaqësues të strukturave të Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë dhe Dhomës së Zejeve në rajonin ky kryen aktivitetin ofruesi i AFP-së. Përzgjedhja e bizneseve bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore.
4. Në përfundim të këtij procesi, ofruesi i AFP-së u dërgon kërkesë zyrtare për bashkëpunim bizneseve, që do të përfshihen në zbatimin e praktikës profesionale në biznes.

Neni 15

Përgatitja për praktikën profesionale në biznes

1. Ofruesi i AFP-së nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me çdo biznes, i cili është i përshtatshëm dhe i gatshëm të angazhohet në zhvillimin e praktikës profesionale në biznes.
2. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, biznesi ngarkon punonjësin / punonjësit e tij, të cilët do angazhohen në proces si instruktorë të biznesit.
3. Në vijim, koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, mësuesi i praktikave profesionale dhe instruktori përgjegjës në biznes planifikojnë zhvillimin e praktikës profesionale në biznes sipas programit të kualifikimit/kursit përkatës.
4. Koordinatori i marrëdhënieve me biznesin, mësuesi i praktikës profesionale në bashkëpunim me instruktorin e biznesit, përcaktojnë numrin e nxënësve/kursantëve dhe periudhën kohore si dhe vëllimin e kohës së zhvillimit të praktikës profesionale në këtë biznes (periudha e vitit, java/javët, dita/ditët) në varësi të kushteve të nevojshme për të nxënë në mjedisin e biznesit (poste pune, etj.).

5. Koordinator i marrëdhënieve me biznesin dhe mësuesi i praktikës profesionale dorëzon në drejtori dokumentacionin e plotë të planifikimit të praktikës profesionale sipas drejtimeve / profileve dhe klasave që do të marrin pjesë në praktikë.
6. Instruktori i biznesit njofton strukturat përkatëse në kompaninë e tij mbi planifikimin e praktikës profesionale në biznes të dakordësuar me mësuesin e praktikës në shkollë.

Neni 16

Vendosja e nxënësve/ kursantëve në biznese për realizimin e praktikës profesionale në biznes

1. Procesi i vendosjes së nxënësve/kursantëve në biznes realizohet nga ofruesi i AFP-së në bashkëpunim të ngushtë me secilin prej bizneseve.
2. Një instruktor i biznesit nuk mund të drejtojë dhe mbikëqyrë më shumë se 5 nxënës/kursantë në praktikën profesionale në biznes.

Neni 17

Përgatitja e nxënësve/kursantëve për praktikën në biznes

1. Në përputhje me planin e dakordësuar ndërmjet ofruesit të AFP-së dhe biznesit, nxënësit/kursantët njoftohen për zhvillimin e praktikës profesionale në biznes.
2. Nxënësit/kursantët përgatiten për t'u prezantuar në biznesin, në të cilin do të kryejnë praktikën profesionale.
3. Çdo biznes njihet me nxënësin/kursantin, që do të kryejnë praktikën profesionale në biznes.
4. Koordinator i marrëdhënieve me biznesin përgatit kontratën tip individuale për çdo nxënës/kursant, e cila pasi kontrollohet nga përgjegjësi i njësisë së zhvillimit, nënshkruhet ndërmjet drejtuesit të ofruesit të AFP-së, biznesit dhe çdo nxënësi / kursanti (ose përfaqësuesit të tij ligjor), që do të ndjekë praktikën profesionale në biznes.

KREU IV

ZBATIMI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE NË BIZNES

Neni 18

Kontrata e praktikës profesionale në biznes

1. Praktika profesionale në biznes zhvillohet në bazë të një kontrate tip , e cila lidhet ndërmjet përfaqësuesve ligjorë të ofruesit të AFP-së, biznesit dhe nxënësit/kursantit, sipas Shtojcës 1 të kësaj Rregulloreje.
2. Në kontratën e praktikës profesionale në biznes përcaktohen detyrimet e secilës palë nënshkruese, kohëzgjatja e praktikës profesionale dhe oraret, legjislacioni i zbatueshëm dhe kushtet e zgjidhjes së kontratës.

Neni 19

Përgjegjësitë dhe funksionet e instruktorit në biznes

Instruktori në biznes ka këto përgjegjësi dhe funksione:

- a. planifikon praktikën profesionale në bashkëpunim të ngushtë me koordinatorin e marrëdhënieve me biznesin dhe mësuesin e praktikave profesionale, të caktuar nga ofruesi i AFP-së.
- b. organizon të gjitha veprimtaritë praktike, që nxënësi/kursanti duhet të zbatojë gjatë praktikës profesionale në biznes.
- c. është përgjegjës për prezantimin e nxënësit / kursantit me stafin, mjediset e biznesit, postin / postet e punës dhe rregullat e sigurisë teknike në punë.
- d. mbikëqyr veprimtarinë e punës, dokumenton rregullisht pjesëmarrjen dhe, si dhe aftësitë e përvetësuara nga e çdo nxënësi/kursanti gjatë praktikës profesionale në biznes dhe ia raporton këtë mësuesit të praktikave profesionale të caktuar nga ofruesi i AFP-së.
- e. kontrollon plotësimin e fletores së praktikës profesionale të nxënësit/kursantit dhe e nënshkruan atë.
- f. në bashkëpunim me mësuesin e praktikave profesionale të caktuar nga ofruesi i AFP-së realizon vlerësimin e vazhduar të nxënësit/kursantit gjatë praktikës profesionale në biznes.
- g. Përgatit një raport për realizimin e praktikave profesionale në biznes nga çdo nxënësi/kursant.

Neni 20

Përgjegjësitë e nxënësit/kursantit

Në përcaktim me kuadrin ligjor në fuqi dhe në zbatim të programit të praktikës profesionale në biznes të dakordësuar ndërmjet ofruesit të AFP-së dhe biznesit, nxënësi/kursanti:

- a. Paraqet raportin e komisionit mjeko-ligjor që është i aftë për punë.
- b. merr pjesë në proceset e punës të parashikuara në programin e praktikave profesionale në biznes;
- c. Gjatë punës, ndjek udhëzimet e instruktorit në biznes dhe të mësuesit të praktikës profesionale në institucionin ofrues të AFP-së.
- d. Respekton etikën dhe disiplinën e punës së biznesit ku kryhet praktika profesionale ku është caktuar;
- e. Mban të ekspozuar mjetin e identifikimit;
- f. Është i/e detyruar të informojë instruktorin e biznesit për arsyet e mungesave eventuale dhe t'i justifikojë ato te mësuesi i praktikës profesionale
- g. Respekton me rigorozitet të gjitha rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë të vendosura nga biznesi ku kryhet praktika profesionale;
- h. Zbaton udhëzimet e instruktorit në biznes, kryen me ndërgjegje punët që i caktohen dhe ruan sekretin profesional;
- i. Shënon në fletoren e praktikës profesionale në biznes çështjet me interes, siç mund të jenë procedura të caktuara pune, skema të reja, informacione të ndryshme, etj.;
- j. Sillet korrekt, mban rregull, është i saktë dhe bën punë të pastër.

Neni 21

Fletorja e praktikës profesionale në biznes

1. Gjatë praktikës profesionale në biznes, nxënësi/kursanti pasqyron rregullisht në fletoren përkatëse detyrat dhe veprimtaritë e kryera, kompetencat profesionale e personale të përvetësuara, si dhe mban shënime rreth proceseve, teknologjive, me të cilat është njohur në biznes.
2. Fletorja është personale e nxënësit/kursantit, por kontrollohet rregullisht dhe nënshkruhet nga instruktori në biznes dhe mësuesi i praktikës profesionale.

3. Shënimet e mbajtura në fletoren e praktikës profesionale merren në konsideratë në vlerësimin e arrietjeve të nxënësit/kursantit gjatë dhe në përfundim të praktikës profesionale në biznes.

Neni 22

Monitorimi i praktikës profesionale në biznes

1. Mësuesi i praktikës profesionale planifikon, në bashkëpunim me instruktorin në biznes, procesin dhe instrumentet e zhvillimit të praktikës profesionale në biznes.
2. Mësuesi i praktikës profesionale monitoron mënyrën dhe rezultatet e praktikës profesionale në biznes të çdo nxënësi/kursanti.
3. Mësuesi i praktikës profesionale në biznes monitoron frekuentimin e praktikës në biznes nga çdo nxënës/kursant, merr nga instruktori i biznesit raportin përkatës dhe e pasqyron këtë në regjistër.
4. Mësuesi i praktikës profesionale pasqyron në dokumentacionin zyrtar rezultatet e vlerësimit të praktikës profesionale në biznes.

KREU VI

VLERËSIMI IPRAKTIKES PROFESIONALE NE BIZNES

Neni 23

Vlerësimi i vazhduar gjatë praktikës profesionale në biznes

1. Vlerësimi i vazhduar i praktikës profesionale në biznes është përgjegjësi e instruktorit në biznes, në bashkëpunim me mësuesin e praktikës profesionale.
2. Mësuesi i praktikës profesionale garanton që vlerësimi i instruktorit në biznes të realizohet në mënyrë objektive dhe reflektohet siçduhet në dokumentacionin zyrtar.
3. Për vlerësimin e vazhduar të nxënësit/kursantit, instruktori në biznes përdor instrumente të dakordësuara me mësuesin e praktikës profesionale të ofruesit të AFP-së.

Neni 24

Vlerësimi përfundimtar

1. Ofruesi i AFP-së zbaton me përpikëri legjislacionin për angazhimin e bizneseve në komisionet e vlerësimit në provimet përfundimtare të praktikës profesionale për çdo kualifikim/kurs profesional.
2. Ofruesi i AFP-së merr masa që në komisionet e vlerësimit të jenë anëtarë specialistë, të cilët janë angazhuar më parë edhe si instruktorë në biznes.

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



Shtojcë 1: Modeli i kontratës së praktikës profesionale në biznes

Kontratë ndërmjet

.....
(biznesit/institucionit)

.....
(emri i ofruesit të AFP-së)
dhe

.....
(praktikantitose përfaqësuesit ligjor)

lindur më në
banues në
nxënës /kursant në shkollën e mesme profesionale / Qendrën shumëfunktionale / Drejtorinë
Rajonale të Formimit Profesional Publik
..... në drejtimin / profilin /
kursin

Neni 1

Objekti i kontratës

Qëllimi i kësaj praktike profesionale është që praktikanti të përvetësojë e të konsolidojë rezultatet e të nxëniet të përcaktuara në programin mësimor të ofruar nga institucioni i AFP-së.

Neni 2

Kohëzgjatja e praktikës profesionale në biznes

1. Periudha e praktikës profesionale në biznes nis më dhe
përfundon më
2. Koha e punës është në përputhje me Rregulloren për Mbrojtjen e
Fëmijëve në Punë, miratuar me VKM nr. 108, datë 15.02.2017, dhe nuk mund të jetë më shumë se
30 orë në javë dhe më shumë se 6 orë në ditë.

Neni 3

Detyrimet e praktikantit

Nxënësi/kursanti praktikant është i detyruar:

- a. të kryejë me kujdes detyrat e caktuara sipas programit të praktikës profesionale;
- b. të ndjekë udhëzimet e dhëna nga instruktori i praktikës në biznes dhe/ose personave të tjerë
përgjegjës;
- c. të respektojë rregulloret e brendshme të biznesit (p.sh. rregullat e mbrojtjes nga aksidentet
në punë, rregullat e higjienës, rregullat e mbikëqyrjes dhe monitorimit);
- d. të përdorë e të kujdeset për veglat e punës, makineritë dhe pajisje të tjera të biznesit;

- e. të mos mungojë gjatë kohës së praktikës (mund të mungojë vetëm me arsye dhe me lejen e instruktorit në kompani dhe duke njoftuar ofruesin e AFP-së dhe në rast mungese për arsye shëndetësore paraqitet raporti mjekësor përkatës).
- f. të sigurojë uniformën dhe mjetet e punës, në rast se këto nuk vihen në dispozicion nga biznesi

Në rastin e praktikantit në moshë të mitur, kujdestari ligjor është i detyruar të garantojë përmbushjen e këtyre detyrimeve nga praktikanti.

Neni 4

Detyrimet e Ofruesit të AFP-së

Ofruesi i AFP-së është i detyruar të:

- a. hartojë programin e praktikës profesionale në bashkëpunim me biznesin;
- b. të monitorojë procesin e përvetësimit të njohurive e kompetencave profesionale sipas përcaktimeve të programit të praktikës profesionale;
- c. të mbështesë instruktorin në biznes në realizimin e detyrës së tij;
- d. të hartojë e të garantojë zbatimin e instrumenteve të vlerësimit të praktikës profesionale në biznes;
- e. të punojë për përmbushjen e detyrimeve të palëve gjatë zbatimit të praktikave profesionale.

Neni 5

Detyrimet e biznesit

Biznesi është i detyruar të:

- a. të vërë në dispozicion një specialist të kualifikuar, i cili të jetë përgjegjës për prezantimin dhe udhëheqjen e praktikantit në detyrat e tij gjatë praktikës;
- b. t'i sigurojë praktikantit pa pagesë uniformën e punës dhe mjetet e nevojshme për formimin e tij profesional, sidomos veglat e punës dhe materialet e punës;
- c. t'i japë praktikantit vetëm detyra, të cilat i shërbejnë zbatimit të programit të praktikës profesionale të dakordësuar me ofruesin e AFP-së;
- d. të zbatojë legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve në punë në rastin e praktikantëve nën moshën 18 vjeç;
- e. të pajisë praktikantin me dokumentacionin e nevojshëm që dëshmon kohëzgjatjen dhe llojin e praktikës profesionale, si dhe veprimtaritë e zhvilluara dhe kompetencat profesionale të përvetësuara gjatë praktikës.

Neni 4

Shpërblimi i praktikantit

Praktikanti nuk paguhet për punën e kryer në kuadër të realizimit të programit të praktikës profesionale të dakordësuar me ofruesin e AFP-së.

Neni 5

Zgjidhja e kontratës

- 5.1. Secila nga palët nënshkruese mund të zgjidhë kontratën brenda 15 ditësh, nga data që ka njoftuar me shkrim palët e tjera, sipas përcaktimeve të këtij neni;
- 5.2. Kjo kontratë mund të zgjidhet prej ofruesit të AFP-së në rastet e mëposhtme:
 - a. biznesi nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj kontrate;

- b. praktikanti nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj kontrate.
- 5.3. Kjo marrëveshje mund të zgjidhet prej biznesit në rastet e mëposhtme:
- Praktikanti shkel detyrimet e kësaj kontrate në mënyrë të përsëritur me gjithë paralajmërimet e biznesit;
 - Praktikanti shkel rregulloren e brendshme të funksionimit të biznesit dhe shkel në mënyrë të përsëritur kodin e etikës, disiplinën e mësimit ose praktikën në biznes me gjithë paralajmërimet e instruktorit në biznes.
 - Praktikanti shpërdoron pasurinë e biznesit apo ka sjellje të padenjë në mënyrë të përsëritur pavarësisht vërejtjeve me gojë e me shkrim nga biznesi;
 - Kur provohet se praktikanti nxjerr të dhëna konfidenciale të biznesit;
 - Praktikanti është dënuar me vendim të formës së prerë nga një gjykatë për një vepër penale në ngarkim të tij.
 - Ofruesi i AFP-së nuk përmbush detyrimet që ka ndaj biznesit
- 5.4. Kjo kontratë mund të zgjidhet prej praktikantit në rastet kur biznesi dhe/ose instruktori në biznes shkelin të drejtat e njeriut, nuk përmbushin detyrimet e tyre për praktikën profesionale sipas kësaj kontrate ose shkelin të drejtat sipas VKM nr. 108, datë 15.02.2017 "Për miratimin e Rregullore 'Për Mbrojtjen e Fëmijëve në Punë'" gjatë orareve të praktikës profesionale në biznes

Neni 6

Mbrojtja nga aksidentet në punë

- 6.1. Në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, praktikanti konsiderohet i mbrojtur dhe përfiton të ardhura e shërbime nga sistemi i sigurimeve shoqërore për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, të cilat do të paguhen nga biznesi.
- 6.2. Në datën e nënshkrimit të kontratës, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 28.1.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", i ndryshuar parashikon se kontributi i detyrueshëm për praktikantin për aksidente në punë është 0.3% e pagës minimale bruto.

Neni 7

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1. Kjo marrëveshje bazohet në ligjin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i saj do të kryhet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar. Për sa kohë nuk parashikohet në këtë kontratë, do të zbatohet veçmërisht, por pa u kufizuar në to, dispozitat e mëposhtme të ndryshuara herë pas here:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 15/2017, datë 15.02.2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 10247, datë 04.03.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", i ndryshuar
- Ligji nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"
- VKM Nr. 108, datë 15.02.2017 Për miratimin e Rregullore "Për Mbrojtjen e Fëmijëve në Punë"
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

g. VKM Nr. 77, datë 28.01.2015, "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", i ndryshuar.

7.2. Në rast mosmarrëveshjes në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate dhe të cilat nuk zgjidhen me mirëkuptim midis palëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor _____.

Palët nënshkruese

Për biznesin

Për Ofruesin e AFP-së

.....
**Praktikanti/Për praktikantin
Prindi/kujdestari ligjor**

.....
Për dijeni të praktikantit

Shtojcë 2: Programi i praktikës profesionale në biznes (format i rekomanduar)

Nr.	Vendi i punës	Veprimtaritë profesionale	Kompetencat profesionale	Koha (ditë/orë)
1				
2				
3				
4				
5				
TOTALI				Xx ditë / orë
Vendi i punës	Kompetencat personale	Veprimtaritë		
	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>			

Shtojcë 3: Fletore e praktikës profesionale në biznes**Emri i nxënësit/kursantit****Biznesi /Departamenti**

Drejtimi/Profili/Klasa/Kursi

Emri i instruktorit në biznes

Kohëzgjatja e praktikës

Emri i mësuesit
të praktikës profesionale

Veprimtari të zhvilluara	Vendi i punës	Koha (ditë/orë)
Kompetenca profesionale të përveçsuara		
Kompetenca personale të përveçsuara		
Veprimtari, procese, teknologji të reja të prezantuara nga biznesi, shënime të tjera		

Nënshkrimi i Praktikantit

Nënshkrimi i instruktorit në
biznesNënshkrimi i mësuesit të
praktikës profesionale